VENDIM
Nr. 10, datë 27.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 7, DATË 11.5.2018, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, "PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I, PËR VITIN 2018, GRANTET 'ARSIMI'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 7, datë 11.5.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2018, grantet 'Arsimi'", bëhen ndryshimet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.

Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja I për vitin 2018, grantet "Arsimi" (arsimi bazë, arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe programi për sportin), me cikël zbatimi 2018–2019

Nr.	**Autoriteti kontraktor**	**Emërtimi i projektit**	**Vlera e plotë e projektit (në lekë)**	**Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2018 (në lekë)**	**Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV-ja (në lekë)**		
					%	**Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)**	**Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2018**
	QARKU TIRANË						
50	Bashkia Kavajë	Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Qerret + ambiente sportive + kopsht	89,978,882	12,597,043	30%	26,993,665	5,398,733
51	Bashkia Rrogozhinë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore e shkollës së mesme "Haxhi Qehaj" Rrogozhinë	94,746,233	17,054,322	10%	9,474,623	1,895,000

Shënime:

Pika 7 e "Shënime", të tabelës 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.7, datë 11.5.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2018, grantet 'Arsimi'", shfuqizohet.